

Ministri Haavisto: Taksa të lihet anash, dialogu të vazhdojë

FAQE 8



22 VJET NGA PROTESTA STUDENTORE E 1 TETORIT E VITIT 1997 ■ FAQE 4-5

PROTESTA E 1 TETORIT E '97-s IA KTUEU POPULLIT SHPRESËN DHE BESIMIN

Protagonistët e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997 e kanë vlerësuar këtë ngjarje shumë të rëndësishme në historinë më të re të Kosovës. Në 22-vjetorin e kësaj proteste ish-drejtnesit e Lëvizjes Studentore të '97-s dhe historianët kanë thënë se kjo ngjarje dinamizojë jetën politike në Kosovë dhe i dha fund lëvizjes paqësore. Ish-kryetari i Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, ka thënë se brezi studentor i '97-s ka arritur qëllimin, duke ngritur një popull të tërë të pasivizuar e të pashpresë. Edhe historiani dhe ish-rektori i Universitetit të Prishtinës, Ibrahim Gashi, ka thënë se ndikimi i kësaj proteste në rrjedhat politike ishte i madh.



FLET PËR "EPOKËN E RE", VALON GRABOVCI

Do të jem zëri i rinisë në Kuvendin e Kosovës

Kandidati për deputet nga radhët e PDK-së, Valon Grabovci, ka thënë se është i nderuar për mundësinë e dhënë që të garojë për deputet nga kjo parti. Ai ka thënë se nuk ka hezituar që t'i hyjë kësaj gare pasi është rritur me PDK-në, të cilën e ka cilësuar parti shtetformuese. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Grabovci është shprehur i

bindur se do të bëhet deputet, duke u zotuar se do të jetë zëri i rinisë në Kuvendin e Kosovës. Ai ka thënë se interesimet kryesore të tij dhe të PDK-së do të jenë ekonomia dhe rinia. "Përkrahja e rinisë është zotim edhe i kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. Jam i sigurt që kandidati ynë për kryeministër do t'ia kthejë dinjitetin jo vetëm rinisë, por edhe Kosovës", ka thënë Grabovci.

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

1 TETORI DHE 'VIZA' AMERIKANE F. 5

Driton LAJÇI



A DUHET TË ARRESTOHET LOKOMOTIVISTI F. 11



Shkruan: Dr. Ilir RRECAJ

AKTUALE



THAÇI DHE CLINTONI KUJTOJNË ANGAZHIMIN PËR LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS F. 2

AAK-ja i BËN THIRRJE PRESIDENTIT QË TA EMËROJË ANËTARIN E SAJ NË KQZ F. 5

EKONOMI

RUKIQI: QASJA NË FINANCA, BARRIERË E TË BËRIT BIZNES NË KOSOVË F. 9

ATK-JA PËRMBYLLI ÇIKLIN E RADHËS TË SEMINAREVE ME TATIMPAGUES F. 9

SPORT

ZHDRELLA: FERONIKELI MERITON RESPEKT, POR NUK ËSHTË I PATHYESHËM F. 18

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi dhe Clintoni kujtojnë angazhimin për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës



PRISHTINË, 30 SHTATOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi është takuar në Francë me ish-presidentin e ShBA-së, Bill Clinton, në kuadër të ceremonisë mortore të ish-presidentit francez, Zhak Shirak.

Thaçi ka thënë se me Clintonin kanë përkujtuar angazhimin e përbashkët për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

"Si gjithmonë kënaqësi të takoj mikun tim dhe të Kosovës, presi-

dentin Bill Clinton. Së bashku e kujtuam presidentin Shirak dhe angazhimin tonë të përbashkët për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Presidenti Hashim Thaçi, në Paris ka takuar edhe homologun gjerman, Frank Walter Steinmaier.

Thaçi ka thënë se Gjermania është partnere strategjike e pazëvendësueshme e Kosovës për forcimin e perspektives

euroatlantike dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

"Me mikun tim, presidentin e Gjermanisë, Frank Walter Steinmeier në ceremoninë mortore për ish-presidentin francez, Jacque Chirac. Gjermania është partner strategjik i pazëvendësueshëm i Kosovës për forcimin e perspektives euroatlantike dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ministri Mustafa viziton zonat e prekura nga tërmeti në Shqipëri

Ministri Ekrem Mustafa në emër të Qeverisë së Kosovës shprehu solidaritetin me qytetarët shqiptarë të prekur tërmeti dhe nënvizoi se qëllimi i vizitës është identifikimi i nevojave dhe mundësive që ka Kosova për të ofruar ndihmë



Prishtinë, 30 shtator - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme i Republikës së Kosovës, Ekrem Mustafa ka qëndruar për një vizitë në Republikën e Shqipërisë, ku u prit nga zëvendësministri i Brendshëm, Julian Hodaj. Mustafa dhe Hodaj zhvilluan një vizitë në Maminas, një nga zonat më të prekura nga tërmeti i 21 shtatorit.

Ministri Mustafa në emër të Qeverisë së Kosovës shprehu solidaritetin me qytetarët shqiptarë të prekur nga kjo situatë dhe nënvizoi se qëllimi i vizitës është identifikimi i nevojave dhe mundësive që ka Kosova për të ofruar ndihmë.

"Unë si ministër i Punëve të Brendshme kam ardhur të solidarizohem me gjendjen aktuale pas tërmetit në Shqipëri, për së afërmi të prekim situatën edhe të shohim, se si t'i identifikojmë problemin edhe nevojën, se çfarë ka mundësi Kosova t'u ndihmojë këtyre qytetarëve dhe

shtetit shqiptar. Ne bashkëpunimin me Qeverinë shqiptare e kemi shumë të mirë, do të thotë edhe bashkëpunimin me Ministrinë e Punëve të Brendshme. I kemi përfunduar të gjitha marrëveshjet që konsistojnë në ndihmat e përbashkëta njëri me tjetrin. Si në këtë rast emergjence, ashtu dhe me probleme të tjera që e ruajnë stabilitetin e shtetit", ka thënë ministri Mustafa.

Ndërsa Julian Hodaj, zëvendësministër i Brendshëm i Shqipërisë u shpreh se janë identifikuar dëmet e shkaktuara dhe tani do të vijojë ndërhyrja për t'i rregulluar banesat, që janë prekur nga tërmeti.

"Situata është pak a shumë ajo që jeni informuar gjatë ditëve të kaluara. Është përmbyllur pothuaj procesi i verifikimit dhe janë përcaktuar edhe prioritetet e ndërhyrjes që do fillojnë kup-tohet nga ato situata që janë më në nevojë urgjente. Ajo që na

ngroh dhe që na kënaq deri diku është që gjithë ai mekanizëm planifikimi dhe ndërhyrjeje, që ishte i planifikuar në letër, e tregoi që edhe në praktikë u zbatua me përpikëri, sa kohë që në orët e para pati një përgjigje të të gjitha strukturave të emergjencës,

duke filluar që nga pushteti qendror duke vazhduar dhe me pushtetin vendor", u shpreh Hodaj.

Ministri Mustafa është takuar edhe me presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta.

"I lumtur t'i shprehja sot ministrit të Brendshëm të Kosovës,

Ekrem Mustafa, mirënjohjen për bashkëpunimin dhe ndihmën e qeverisë së Kosovës, për tejkalimin e pasojave të tërmetit", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook". "Shqipëria dhe Kosova çdo herë të parat në krah të njëra-tjetrës", ka shkruar Meta.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për negociatat

TIRANË, 30 SHTATOR - Është zbardhur rezoluta e Kuvendit për integrimin e Shqipërisë në BE. Sipas kësaj rezolute, institucionet duhet të vijnë punën me reformat e ndërmarra. "Duhet rezultate konkrete në pesë prioritetet kyçe në çeljen e negociatave", thuhet në rezolutë. "Prandaj me anë të kësaj projektrezolute kërkohet që institucionet shqiptare, bazuar në parimet demokratike, në

institucionet demokratike dhe me një përfaqësim të ligjshëm të vijnë të përqendruar në reformat e ndërmarra dhe t'i përfundojë ato në respektim të kuadrit kushtetues e ligjor në fuqi, duke bërë të mundur rezultate konkrete në zbatimin e përparësive të vendosura nga Komisioni Evropian për hapjen e negociatave deri në anëtarësimin me të drejta të plota në Bashkimin Evropian. Projektrezoluta

u drejtohet gjithashtu edhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian në kuadër të samitit të ardhshëm të Këshillit Evropian cili do të mbahet më 17-18 tetor 2019, ku një ndër pikat e diskutimit në rendin e ditës do të jenë edhe vendimet për hapjen e negociatave me Republikën e Shqipërisë dhe me Republikën e Maqedonisë së Veriut", shkruhet ndër të tjera në rezolutë.



Flet për "Epokën e re", Valon Grabovci

Do të jem zëri i rinisë në Kuvendin e Kosovës



Kandidati për deputet nga radhët e PDK-së, Valon Grabovci, ka thënë se është i nderuar për mundësinë e dhënë që të garojë për deputet nga kjo parti. Ai ka thënë se nuk ka hezitur që t'i hyjë kësaj gare pasi është rritur me PDK-në, të cilën e ka cilësuar parti shtetformuese. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Grabovci është shprehur i bindur se do të bëhet deputet, duke u zotuar se do të jetë zëri i rinisë në Kuvendin e Kosovës. Ai ka thënë se interesimet kryesore të tij dhe të PDK-së do të jenë ekonomia dhe rinia. "Përkrahja e rinisë është zotim edhe i kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. Jam i sigurt që kandidati ynë për kryeministër do t'ia kthejë dinjitetin jo vetëm rinisë, por edhe Kosovës", ka thënë Grabovci

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Valon Grabovci, kandidat për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka thënë se ka qenë i nderuar për besimin që i është dhënë nga kjo parti për të garuar për deputet. Në këtë intervistë për "Epokën e re", Grabovci ka falënderuar kryetarin e PDK-së, Kadri Veseli dhe degën e kësaj partie në Pejë, për ta sfiduar veten në garën për deputet. Grabovci, i cili me profesion është ekonomist, ka thënë se interesimet e tij si politikan do të jenë ekonomia dhe ndërmarrësia. "Interesimet tona kryesore duhet të jenë ekonomia dhe ndërmarrësia", ka thënë Grabovci. Më tutje, ai është shprehur i bindur se do ta fitojë garën për deputet. Në këtë kontekst, Grabovci është zotuar se do të jetë zëri i rinisë në Kuvendin e Kosovës. "Rinia më shumë se kurrë ka nevojë për përkrahje. Kjo përkrahje nuk do të mungojë. Përkrahja e rinisë është edhe zotim i kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. Jam i sigurt se kandidati ynë për kryeministër do t'ia kthejë dinjitetin jo vetëm

rinisë, por edhe Kosovës", është shprehur Grabovci, duke ftuar qytetarët e Kosovës, në veçanti rininë, që më 6 tetor ta votojnë PDK-në. "Vota për PDK-në është votë kundër korrupsionit dhe pro zhvillimit ekonomik. Po ashtu, vota për PDK-në është votë pro orientimit euroatlantik të Kosovës dhe kundër izolimit", ka deklaruar Grabovci.

"Epoka e re": Z. Grabovci, për çfarë arsyesh vendoset të garoni për deputet të Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së?

Grabovci: Fillimisht dua t'ju informoj se jam rritur me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK). Kontributi i familjes sime, miqve dhe kolegëve, është i lidhur me këtë parti shtetformuese. Po ashtu, familja ime ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për çlirimin e Kosovës. Babai im ka qenë një ndër të parët që është angazhuar në UÇK, ku edhe ka rënë heroikisht në luftën për liri. Ai tani është hero i Kosovës. Kjo më bën të ndihem krenar dhe të punoj fort për vendin. Përpos babait tim, edhe xhaxhai, Ademi, ka qenë aktivist i rrallë, i cili ishte i angazhuar në të gjitha etapat e rrugëtimit të Kosovës për liri dhe

pavarësi. Ai ka qenë i angazhuar maksimalisht në ilegale, duke bartur funksione të ndryshme. Në funksion të kësaj, xhaxhai im ka qenë i burgosur politik, një ndër themeluesit e aksionit të pajtimeve të gjakeve dhe një nga themeluesit e UÇK-së e anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Duke e marrë parasysh këtë bagazh të familjes sime, e pas konsultimeve me të, miqtë dhe kolegët, nuk e kam pasur aspak të vështirë të pranoj të garoj për deputet nga radhët e PDK-së. Në këtë drejtim dua ta falënderoj liderin e PDK-së dhe degën e kësaj partie në Pejë, pjesë e secilës jam, për besimin e dhënë në garën për zgjedhjet e 6 tetorit. E kam thënë edhe herëve të tjera, se me profesion jam ekonomist dhe inkuadrimi im në politikë aktive ka për qëllim zhvillimin ekonomik të vendit. Mendoj se tani është koha që interesimet tona kryesore të jenë ekonomia dhe ndërmarrësia.

"Epoka e re": Vetëm ekonomia?
Grabovci: Jo vetëm ekonomia, por edhe rinia. Me fjalë të tjera, zotohem se do të jem zëri i rinisë në Kuvendin e Kosovës. Mendoj se rinisë së Kosovës më shumë se

kurrë i duhet hapja e një perspektive e cila do ta mbajë rininë këtu. PDK-ja në këto zgjedhje e ka programin më të mirë për rininë. Këtë program do të insistoj në vazhdimësi që të zbatohet në praktikë. Rinia më shumë se kurrë ka nevojë për përkrahje, dhe kjo përkrahje nuk do të mungojë. Përkrahja e rinisë është edhe zotim i kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. Jam i sigurt se kandidati ynë për kryeministër do t'ia kthejë dinjitetin jo vetëm rinisë, por edhe Kosovës.

"Epoka e re": Kur flisni për rininë, si është duke ju pritur elektorati i PDK-së në këtë garë elektorale?

Grabovci: Jam i impresionuar me përkrahjen jo vetëm të rinisë, por të çdo kategorie shoqërore kudo që jam duke shkruar. Kohët e fundit kam lëvizur pothuajse në çdo komunë të Kosovës, ku kam takuar qytetarë të sinqertë, punëtorë dhe të cilët e duan vendin e tyre, Kosovën. Nga takimet me qytetarë kam dëgjuar me vëmendje shqetësimet e tyre për të cilat do të angazhohen maksimalisht, që shqetësimet dhe kërkesat e tyre t'i adresojë në rrugë institucionale, duke ofruar zgjidhje konkrete.

"Epoka e re": Nga këto takime, jeni optimist se do ta fitoni garën për deputet?

Grabovci: Për nga natyra jam optimist, prandaj duke parë gjendjen në terren, besoj fuqishëm se pas 6 tetorit do të jem deputet i Kuvendit të Kosovës. Këtë e them edhe nga takimet me qytetarë dhe nga entuziazmi i tyre për PDK-në dhe për kandidatin tonë për kryeministër, Kadri Veseli.

"Epoka e re": Cili është mesazhi juaj për qytetarët për zgjedhjet të cilat do të mbahen në këtë javë?

Grabovci: Zgjedhjet e 6 tetorit do të jenë determinuese se kah do të shkojë Kosova. Duke parë kundërshtarët tonë politikë, mendoj se PDK-ja është larg sa i përket vizionit dhe programit qeverisës për katër vjetët e ardhshëm. Me këtë rast, ftoj qytetarët e Kosovës, pa dallim, të rinj e të moshuar, që ta votojnë PDK-në më 6 tetor. Vota për PDK-në është votë kundër korrupsionit dhe pro zhvillimit ekonomik. Po ashtu, vota për PDK-në është votë pro orientimit euroatlantik të Kosovës dhe kundër izolimit.

22 vjet nga protesta studentore e 1 tetorit e vitit 1997

Protesta e 1 tetorit e '97-s ia ktheu popullit shpresën dhe besimin

Protagonistët e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997 e kanë vlerësuar këtë ngjarje shumë të rëndësishme në historinë më të re të Kosovës. Në 22-vjetorin e kësaj proteste ish-drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s dhe historianët kanë thënë se kjo ngjarje dinamizojë jetën politike në Kosovë dhe i dha fund lëvizjes paqësore. Ish-kryetari i Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, ka thënë se brezi studentor i '97-s ka arritur qëllimin, duke ngritur një popull të tërë të pasvizuar e të pashpresë. Edhe historiani dhe ish-rektori i Universitetit të Prishtinës, Ibrahim Gashi, ka thënë se ndikimi i kësaj proteste në rrjedhat politike ishte i madh



Arkivi i UPSUP-së. Nisja nga Velania më 1 tetor 1997. Rektori Statovci në mes, Bujar Dugolli e Muhamet Mavraj në të djathtë, kurse në të majtë Driton Lajçi dhe Albin Kurti. Në rreshtin e dytë Hajrullah Koliqi e Ahmet Geca, Milot Cakaj (me flamur), ndërsa Ilir Dugolli e Lulzon Jakgjiu, duke i bartur pankartat me logon e Universitetit të Prishtinës. Në rreshtin e tretë Emrush Gashi, Jeton Rexha, Ernest Luma, Luan Gara dhe Ekrem Ademi.

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Ish-drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s dhe historianët kanë vlerësuar lart ndikimin e protestës së 1 tetorit të vitit 1997 në proceset e mëvonshme politike. Në 22-vjetorin e kësaj proteste ata kanë vlerësuar se kjo ngjarje dinamizojë jetën politike në Kosovë dhe i dha fund lëvizjes paqësore.

Ish-kryetari i Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, ka thënë se studentët me protestat e tyre arritën t'ia kthejnë shpresën popullit të Kosovës. Në profilin e vet në "Facebook", Dugolli ka shkruar se 1 tetori i

vitet 1997 ishte një fillim vendimtar për lirinë e Kosovës. "Kush do të besonte se rruga tatëpjetë e lagjes Velania në Prishtinë do të ishte vendi që do ta thyente heshtjen tonë e do të fillonte zëri që do të dëgjohej gjithandej. Rezistenca filloi, heshtja u thye, kthesa u arrit", ka shkruar ai. Sipas Dugollit, kjo protestë e ngriti popullin e pasvizuar. "Brezi studentor i '97-s ka arritur qëllimin, duke ngritur një popull të tërë të pasvizuar e të pashpresë, duke ia kthyer popullit shpresën dhe besimin se gjërat mund të bëhen dhe duhet të bëhen, por ky brez edhe sot, sikundër edhe brezat e tjerë, ka se çfarë t'i japë Kosovës dhe institucioneve të

saj në të gjitha sferat. Dëshmi është koha, 1 tetori është garancia", ka shkruar Dugolli. Ai ka theksuar se dita e parë e tetorit është edhe ditë e përkujtimit të secilit student e profesor që ra dëshmor. "Është ditë përkujtimi edhe për rektorin historik, profesor Ejup Statovci. Është ditë falënderimi e mirënjohjeje për secilin qytetar të Kosovës që lëshoi shtëpitë për universitetin dhe shkollën shqipe. Është mirënjohjeje për secilin që iu bashkuan 27 mijë studentëve që atë kohë i kishte universiteti ynë si dhe mijëra vullnetarëve e aktivistëve që numëronte lëvizja jonë studentore", ka thënë Dugolli. Edhe historiani dhe ish-rektori

i Universitetit të Prishtinës, Ibrahim Gashi, ka thënë për "Epokën e re" se ndikimi i kësaj proteste në rrjedhat politike ishte i madh. Ai ka deklaruar se protesta e 1 tetorit e vitit 1997 ka shënuar fundin e lëvizjes paqësore. "Protesta studentore e vitit 1997 është një ngjarje e shënuar në historinë më të re të Kosovës. Kjo dhe këto protesta kanë lëvizur procesin e lëvizjes për çlirim dhe pavarësi të vendit një hap më tutje. E them kështu sepse këto protesta shumica e autorëve perëndimorë i konsiderojnë si fundin e lëvizjes së rezistencës paqësore. Në fakt, autori Hovort Clark protestën e 1 tetorit e quan si fundin e veprimit joviolent. Sipas tij, protesta shpërfaq në një farë mënyre dështimet e lëvizjes paqësore për ta çuar përpara çështjen e Kosovës. Pra, pas këtyre protestave fillon të dalë në plan të parë lëvizja aktive, pra lëvizja e armatosur për çlirimin e Kosovës", ka thënë Gashi.

Ndërsa Driton Lajçi, një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore, 22-vjetorin e kësaj proteste ua ka dedikuar diplomatëve amerikanë të cilët i kanë dhënë mbështetje të madhe kësaj proteste. Këtë përvjetor ai e ka ndërlidhur me fillimin e dhënies së shërbimeve konsullore në Ambasadën Amerikane në Prishtinë. Ai e ka falënderuar ish-ambasadorin e ShBA-së në Beograd, Richard Miles, ish-sekretarin e parë të ambasadës që mbulonte Kosovën, Nicholas Hill, dhe ish-shëf-in e zyrës së Kosovës, Michael McClellan. "Sot na duhet viza e udhëtimit, e shkëmbimit të përvojave, vizitave turistike, familjare, biznesit, arsimit, shoqërisë civile e fuqizimit shumëdimensional të raporteve me ShBA-në etj. Në vitin 1997 dukej e pabesueshme se do të jetojmë këtë ngjarje në shtetin tonë, të lirë, të pavarur, demokratike, më të drejta për minoritarët e Kosovës. Andaj këtë përvjetor ua dedikoi diplomatëve amerikanë që i përmenda më lart për mbështetjen që na kanë dhënë. E ripërsëris rolin e madh të studentëve, rinisë, profesorëve, rektorit Statovci, gjithë gjeneratës sime, shokëve të lëvizjes studentore, familjeve tona që jetuam çaste dramatike, flijuam dhe triumfuam kundër së keqe.



VAZHDOHET MARSHI I MBETUR NË GJYSMË NGA VITI 1997

Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim dhe Admovere do të mblidhen më 1 tetor tek ish-ndërtesa e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës në Velani, në rrugën "1 Tetori", për ta vazhduar marshin e ndërprerë në vitin 1997 nga forcat e regjimit të Millosheviqit. Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", në faqen e ORCA-s është bërë me dije se marshi do të fillojë prej shtëpisë së familjes Shoshi në rrugën "1 Tetori", në orën 12:00, dhe do



1 TETORI DHE “VIZA” AMERIKANE



Driton LAJÇI

Ishte muaji gusht, ishte viti 1997. Ne drejtuesit e Lëvizjes Studentore morëm ftesën që të merrnim pjesë në një takim, siç thuhej, të rëndësishëm, që duhej të mbahej në Ambasadën e ShBA-së në Beograd. Lëvizja më dërgoi mua. Nuk e dija se kënd do ta takoja. Megjithatë, e dija se ishte me rëndësi thelbësore të përçohesh qëllimi i protestave tona dhe të paraqitej drejtpërdrejt tek administrata amerikane. Ai që na kishte ftuar ishte emisari i presidentit Clinton për Ballkan, z. Robert Gelbard. Në takim ishin ambasadori i ShBA-së në Beograd, Richard Miles, sekretari i parë i Ambasadës që mbulonte Kosovën, Nicholas Hill (vëllai i Christopher Hillit), shefi i Zyrës së Kosovës, Michael McClellan, shefi në ardhje i zyrës informative, Richard W. Huckaby.

Në takim ishin të ftuar edhe përfaqësues të klasës politike. Z. Gelbard fliste me ton miqësor e herë qortues ndaj klasës politike të asaj kohe. Më pas z. Gelbard është kthyer kah unë duke shtruar pyetjen: Të shohim çfarë po ofrojnë studentët?

E kam thënë fjalën time për planet që bënim për aktivitet paqësor, jo të dhunshëm, studentor, duke potencuar dhunën ndaj studentëve dhe kërkesën për lirinë e objekteve universitare. Ishte pozicionim politik fillestar i profilit jo të lartë. Kërkesa për lirinë e objekteve shkollore dhe universitare me moto, "Sot, nesër është vonë", dhe demonstrim paqësor dhe jo të dhunshëm studentor në rrugët e Kosovës. Ama synimi përfundimtar ishte liria e Kosovës. Z. Gelbard tha: Nëse demonstrimi juaj është paqësor, jo i dhunshëm, studentor, do ta keni mbështetjen e ShBA-së. Ne do të marrin pjesë në vrojtim të protestave studentore. Ashtu edhe ndodhi. Këtu morëm vizën e madhe për qëllimin tonë që të ecim drejt lirisë dhe paqes.

Këtë vit është përfunduar Ambasada e ShBA-së në Republikën e Kosovës. Nga sot,

1 tetor 2019, shërbimi konsullor i Ambasadës do t'i japë të gjitha llojet e vizave në Ambasadën e ShBA-së në Prishtinë. Lajm i mirë për qytetarët tanë që nuk duhet të udhëtojnë në kryeqytetet rajonale për të aplikuar për vizë. Kjo është mrekullia e paqes, lirisë dhe pavarësisë sonë. Atëherë na duhej mbështetja për ta kundërshtuar të keqen, sot na duhet viza e udhëtimit, e shkëmbimit të përvojave, vizitave turistike, familjare, biznesit, arsimit, shoqërisë civile e fuqizimit shumëdimensional të raporteve me ShBA-në etj. Në vitin 1997 duke e pabesueshme se do të jetojmë këtë ngjarje në shtetin tonë të lirë, të pavarur, demokratik, me të drejta për minoritarët e Kosovës. Andaj këtë përvjetor ua dedikoi diplomatëve amerikanë që i përmenda më lart, që na dhanë mbështetjen jetike. Natyrisht, e ripërsëris rolin e madh të studentëve, rinisë, profesorëve, rektorit Statovci, gjithë gjeneratës sime, shokëve të Lëvizjes Studentore, familjeve tona që përjetuam çaste dramatike, flijuam dhe triumfuam kundër së keqes.

(Autori është një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore)

të përfundojë te kompleksi i sotëm i Universitetit të Prishtinës. "Ky marsh organizohet për t'i nderuar të gjitha familjet që mundësuan arsimin në shtëpitë e tyre private gjatë atyre viteve kur ai ishte ndaluar për shqiptarët nga regjimi i Millosheviqit. Po ashtu, për ta përkujtuar rezistencën e shoqërisë sonë që u përpoq shumë për të drejtën themelore të qasjes në arsim", është thënë në postimin e ORCA-s. Të interesuarit mund ta marrin autobusin urban numër 4 dhe duhet të ndalen në stacionin te lagja "Taslixhe", nga ku vendi i nisjes së marshit është 4 minuta larg. Ndërkaq, nisja e organizuar nga qyteti do të menaxhohet nga ORCA dhe Admovere. Të interesuarit për transport të organizuar duhet të jenë para Ministrisë së Arsimit në Prishtinë në orën 11:20, nga bëhet nisja me taksì.



Osmani i ofron partneritet diasporës për investime në Kosovë

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Kandidatja për kryeministre e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, ka vazhduar fushatën zgjedhore në Ferizaj. Para simpatizantëve të pranishëm ajo ka thënë se LDK-ja nuk do të diskutojë për asnjë çmim për shtetësinë e Kosovës. "Presidenti Rugova e donte një republikë që askush nuk ia cenon kufijtë, e këtë e garanton vetëm LDK-ja. LDK-ja nuk diskuton me askënd për asnjë çmim për shtetësinë e Kosovës. Vetëm ne mund ta bëjmë këtë sepse vetëm ne nuk jemi të shantazhuar", ka theksuar ajo, duke premtuar reforma në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë. "LDK-ja është partia e vetme që garanton zhvillim ekonomik, mundësi për secilin qytetar, reformim të thellë në arsim e shëndetësi. Qeveria e zhvatjes nuk e ka trajtuar kurrë

Ferizajn si taksapagues të rëndësishëm, por qeveria jonë do të jetë në shërbimin tuaj. Duhet t'ua njohim mërgimtarëve tanë këto merita për zhvillimin e vendit tonë", është shprehur Osmani. Po ashtu, kandidatja për kryeministre të hënën ka mbajtur tubim elektorale edhe me qytetarët e Kaçanikut, ku i ka ofruar partneritet diasporës për investime në Kosovë. "E ftojme diasporën tonë për partneritet, që të mobilizohet sërish, që kapitalin e krijuar me mund dhe me djersë për këta 30 vjet në vendet e Perëndimit, të vijë ta investojë këtu në Kaçanik dhe në gjithë Kosovën", ka deklaruar Osmani. Ajo ka theksuar se diaspora gjithmonë ka treguar dhe vazhdon të tregojë gatishmëri për të investuar në Kosovë, por tani me qeverisjen e saj do të kenë projekte



konkrete nga të cilat do të përfitojë ekonomia jonë, familjet e tyre dhe ata si investitorë. Sipas saj, Kaçaniku nuk duhet të mbetet vetëm vend i heroizmave, por duhet të bëhet vend me

mundësi të mëdha zhvillimi. "Disa politikanë ju respektojnë për të djeshmen, por ua kanë errësuar të sotmen, ua kanë errësuar të ardhmen, pasi që flasin për Kaçanikun legjendar

dhe nuk kanë bërë asgjë për banorët e kësaj ane", ka thënë Osmani. Kandidatja për kryeministre e LDK-së, Vjosa Osmani, ka mbajtur aktivitete elektorale edhe në Lipjan.

Limaj: Ashtu siç i pata rregulluar rrugët, do ta zhvilloj edhe bujqësinë

PRISHTINË, 30 TETOR (ER) - Kandidati për kryeministër i koalicionit Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, ka premtuar se do të jetë në mbështetje të të gjithë atyre njerëzve që kanë nevojë për shtetin. Në tubimin elektorale në Malishevë ai ka thënë të hënën se i duhen deputetë dhe ministra që nesër do të merren me zgjidhjen e problemeve të qytetarëve të Kosovës. "Nisma do të jetë afër atyre njerëzve që kanë nevojë për mbështetjen e shtetit. Ne do të vazhdojmë të jemi në mbështetje të punëtorit, të rinjve, të pensionistëve, të arsimtarit dhe të gruas. Ne duam të kemi deputetë i cili në



Kuvend do të flasë për problemet e qytetarëve të Kosovës. Ne duam të kemi ministra që ua zgjidhin problemet qytetarëve",

ka thënë Limaj. Ai është zotuar para bashkëvendësve të vet se ashtu siç i ka rregulluar rrugët e

Kosovës, do ta rregullojë edhe bujqësinë. "Nëse e kemi besimin e qytetarëve të Kosovës nuk do të njihet bujqësia pas katër vjetëve, sepse me punën tonë do ta ndryshojmë krejtësisht atë sikurse i kemi ndryshuar rrugët e Kosovës", ka thënë Limaj. Ai ka folur edhe për procesin e dialogut me Serbinë, duke thënë se nuk ka forcë që mund ta detyrojë që të nënshkruajë marrëveshje jo të mirë për Kosovën. Sipas Limajt, Kosova duhet ta përfundojë edhe këtë proces për t'ia hapur vetes perspektivën e zhvillimit dhe të integritetit evropian.

Ndërsa kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës, Jakup Krasniqi, ka thënë se më 6 tetor qytetarët e Malishevës duhet ta mbështesin Fatmir Limajn për kryeministër. "Më 6 tetor është dita kur sovranit duhet ta votojë kandidatin e koalicionit bashkë për shtetin, sepse janë njerëzit që dinë dhe duan t'i mbrojnë interesat e kombit. Më 6 tetor është dita kur sovranit duhet ta mbështesë Fatmir Limajn për kryeministër të ardhshëm të Kosovës. Sa më e madhe të jetë përkrahja për Limajn aq më e fuqishme do të jetë Kosova përballë sfidave që e presin pas 6 tetorit", ka thënë Krasniqi.

Kurti: Me Vetëvendosjen në qeveri e heqim frikën dhe e rikthejmë shpresën

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Kandidati për kryeministër nga Lëvizja Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, të hënën e ka vazhduar fushatën zgjedhore në Malishevë. Para simpatizantëve të pranishëm në Shtëpinë e Kulturës "Tahir Sinani", ai ka thënë se autostradat e mbyllura i kanë ngulfatur komunat, tokat bujqësore dhe i kanë detyruar banorët të shpërngulen. Ai ka premtuar se me qeverinë Kurti dhe me grantin e katërt për komunat prej 600 milionë eurosh për katër vjetet e mandatit, komunat do të kenë

mundësi të investojnë në infrastrukturë, shkolla e ujësjellës. "As nuk do të tolerojmë që ujërat e zeza të bëhen ujëvarë e as nuk do të lejojmë që ujëvara e Mirushës të ketë ujëra të zeza", është shprehur Kurti. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i mposhtin varfërinë dhe frikën sepse aty ku populli ka frikë nga qeveria, ka tirani dhe aty ku qeveria ka frikë nga populli, ka demokraci. "Me Vetëvendosjen në qeveri e heqim frikën dhe e rikthejmë shpresën. Qytetarët po e duan Lëvizjen e do ta votojnë numrin 126 masivisht sepse

Lëvizja po i jep kuptim të shkuarës së tyre, po i jep shpresë të tashmes dhe po ka vizion për të ardhmen", ka deklaruar Kurti. Ndërsa kandidatja për deputete, Albulena Haxhiu, ka thënë se populli po e mbështet Lëvizjen sepse Vetëvendosja nuk e ka tradhtuar e mashtruar asnjëherë. "Për dallim nga të tjerët, Vetëvendosja i sheh qytetarët në sy tek u kërkon mbështetje për zgjedhjet e 6 tetorit", është shprehur Haxhiu. Lëvizja Vetëvendosje e ka vazhduar fushatën zgjedhore edhe Deçan dhe në Gjilan.



Veseli: Fitoret për Kosovën fillojnë çdoherë në Drenicë

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, të hënën ka kërkuar mbështetjen e Drenasit për t'i fituar zgjedhjet e 6 tetorit. Me këtë rast ai ka thënë se fitoret për Kosovën fillojnë çdoherë në Drenicë. "Fitoret për Kosovën fillojnë çdoherë në Drenicë. Fitorja e PDK-së do të fillojë në Drenas, do të vazhdojë në Mitrovicë, në Ferizaj, në Prizren dhe do të vulojë në

Prishtinë më 6 tetor", ka deklaruar Veseli. Duke shpalosur programin qeverisës para qytetarëve të kësaj komune, Veseli ka premtuar mbështetje për të gjitha shtresat e shoqërisë. "Projekti i PDK-së është që ta mbajë popullin e bashkuar dhe jo të përçarë. Do t'i përkrahi në veçanti luftëtarët e lirisë, familjarët e dëshmorëve, pensionistët, rininë, bujqit, ndërmarrësit dhe të gjitha shtresat e shoqërisë",

është shprehur ai. Veseli ka premtuar se gjatë mandatit të tij do ta fuqizojë partneritetin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Do ta fuqizoj partneritetin e Kosovës me ShBA-në. Si mund të ecë Kosova përpara duke qenë e izoluar? Si mund të ecë përpara Kosova duke u konfrontuar me miqtë e vet. Ne duhet të kemi stabilitet politik dhe partneritet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe duhet ta ndër-

tojmë vizionin për Kosovën e zhvilluar", ka thënë ai. Veseli ka theksuar se qytetarët e Kosovës më 6 tetor do të gjenen para dy zgjedhjeve, atij të koalicionit të shpresës me ShBA-në dhe koalicionit të izolimit. "Më 6 tetor zgjedhja është mes koalicionit të shpresës me ShBA-në dhe koalicionit të izolimit dhe të thellimit të korrupsionit. Më 6 tetor PDK-ja kandidon me 110 kandidatë. Ju bëj thirrje,

Drenas dhe Drenicë, që masivisht t'i përkrahni të gjithë kandidatët tuaj sepse duhet t'i keni në Kuvendin e Kosovës. Bëhuni bashkë për fitoren e Kosovës sonë. Kur fiton PDK-ja, fiton Kosova, e kur është e fortë Kosova, është e dobët vetëm Serbia", ka deklaruar Veseli. Kandidati për kryeministër i PDK-së, Kadri Veseli, fushatën zgjedhore të hënën e ka vazhduar edhe në Istog.



Haradinaj kërkon mbështetjen e Llapit për Kosovën 100 % shtet

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Kandidati për kryeministër nga radhët e koalicionit AAK-PSD, Ramush Haradinaj, të hënën ka mbajtur tubim elektorale në Podujevë, ku ka kërkuar besimin e llapjanëve për ta realizuar konceptin 100 % shtet. "Më 6 tetor duhet vendosur për dy Kosova. Një Kosovë është Albini, Kadria, Vjosa që po nguten se cili të japë diçka shumë për t'i hyrë në hatër dynjasë dhe me u dok të moderuar. Ato që po i japin ata janë për Serbinë si, për shembull, reciprociteti dhe heqja e takës. Dhe është një Kosovë, kjo e jona 100 % shtet, miku mik, po ne jemi zotë të shtëpisë dhe vendosim vetë. Komshiut po i tregojmë njëherë e përgjithmonë se i ka vdekur nëna atij vakti kur t'i ke vendos se çka bëhet në Kosovë. Kësaj treve shpinën nuk do t'ia

kthejmë kurrë, por do të bëjmë më shumë për Llap nëse ma jepni besimin", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se në mandatit të tij qeverisës do të realizohen shumë projekte për Llapin. "Në Llap ka edhe shumë punë për t'u bërë dhe unë e kam një listë të madhe të projekteve që do t'i realizojmë. Në qeverisjen tonë të ardhshme do të fokusohemi në zhvillim ekonomik, arsim dual, shëndetësi, shtesa të fëmijëve, sistem pensional të qëndrueshëm, përkujdesje për pleq si dhe hapje të më shumë çerdheve", ka thënë ai. Haradinaj ka thënë se qeveria e tij nuk është e fjalëve, por e veprimeve konkrete. "Pagat do t'i rrisim çdo vit nga 10 për qind. Nuk ka pagë minimale dhe as pension që paguhet prej shtetit nën 250 euro", ka theksuar ai.



Ministri i Punëve të Jashtme i Finlandës, Pekka Haavisto, ka vizituar Kosovën

Ministri Haavisto: Taksa të lihet anash, dialogu të vazhdojë

Taksa ndaj produkteve serbe duhet të lihet anash dhe dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojë. Kështu ka deklaruar të hënën në Prishtinë ministri i Punëve të Jashtme i Finlandës, Pekka Haavisto, në një konferencë të përbashkët për medie me homologun e vet Behgjet Pacolli. Kurse sa i përket liberalizimit të vizave për Kosovën, ai ka thënë se Finlanda është duke u angazhuar në këtë proces, por vendimi do të merret nga Këshilli i Ministrave i BE-së

**EPOKA E RE** **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Ministri i Punëve të Jashtme i Finlandës, Pekka Haavisto, ka qëndruar të hënën për vizitë zyrtare në Kosovë, ku është pritur në takime të ndara nga kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj dhe ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli. Me këtë rast, ministri finlandez ka thënë se taksa ndaj produkteve serbe duhet të lihet anash dhe bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojnë. "Ka disa çështje që ju përmendët e që nuk kanë avancuar aq sa do të donim siç është dialogu Kosovë - Serbi. E keni mbështetjen tonë të plotë për t'i vazhduar bisedimet.


Neve nuk na pëlqen që ka avokim kundër jush në disa kontekste. Kjo nuk është e pranueshme. Gjithashtu, ka disa çështje sa i përket tarifës dhe politikave. Shpresoj të gjitha këto çështje të lihen anash dhe bisedimet në mes të Kosovës dhe Serbisë të vazhdojnë", ka deklaruar Haavisto në një konferencë të përbashkët për medie me homologun e vet Behgjet Pacolli. Ai ka folur edhe për çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën, duke thënë se është duke u punuar në këtë drejtim, megjithatë Haavisto ka thënë se vendimi merret nga Këshilli i Ministrave i BE-së. "E përmendët edhe liberalizimin e vizave, por kjo është një çështje e Këshillit të Bashkimit Evropian. Jemi duke

punuar edhe në atë çështje", ka theksuar ai, duke shtuar se Finlanda ka qenë përkrahëse e pavarësisë dhe vazhdon ta përkrahë Kosovën në aktivitete ndërkombëtare. "I thashë ministrit që kur isha për herë të parë në Kosovë në vitin 1990 i pata parë qytetarët që kërkonin mbrojtje. Ju përgëzoj për punën që keni bërë dhe e di se keni fushatë, por ju falënderoj që keni gjetur kohë për ne. Diaspora në Finlandë është e njohur si në bujqësi, sport e shumë të tjera. Ne kemi qenë përkrahës jo vetëm në pavarësi, por edhe në aktivitete të tjera ndërkombëtare", ka thënë Haavisto.

Ndërsa zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka thënë se miqësia me Finlandën është shumë e veçantë. Ai e ka falënderuar dhe i ka shprehur mirënjohje ministrit Pekka Haavisto për mbështetjen e vazhdueshme dhe të parëzervë të Finlandës në procesin e shtetndërtimit dhe integriteteve euroatlantike për Republikën e Kosovës. "Presim edhe më tej të thellohet dhe zgjerohet bashkëpunimi në mes të Kosovës dhe Finlandës në sistemin e

edukimit dhe ndërlidhjes me ekonominë e Kosovës si dhe nevojave të saj për kuadro të specializuara", ka deklaruar Pacolli. Ai ka bërë me dije se i ka thënë homologut të tij finlandez se Kosova pret nga Finlanda, si kryesuese e Presidencës së BE-së, që ta ndihmojë fuqishëm procesin e liberalizimit të vizave. "Ju e dini se Finlanda ka marrë presidencën e BE-së dhe ne kishim një takim edhe më herët. Jam i lumtur që homologu im vizitoi Kosovën dhe mund të them se marrëdhëniet tona janë të mira. Nuk kemi asnjë problem që mund ta dëmtojë këtë marrëdhënie. Kemi nënshkruar disa marrëveshje dhe kemi filluar disa nisma dhe do të vazhdojmë edhe në të ardhmen. E njoftova kolegun tim për procesin zgjedhor dhe, po ashtu, e njoftova se qeveria e ardhshme do të jetë shumë më e kujdesshme për krijimin e kushteve për të filluar dialogu me Serbinë dhe që ky proces të përfundojë me njohje reciproke", ka thënë Pacolli, duke shtuar se ka marrë garanci nga homologu i tij për ta mbështetur liberalizimin e vizave për Kosovën. "Në takim kolegu im më tha se do të angazhohet që kosovarët të lëvizin

lirshëm sepse Kosova ka bërë hapa të mëdhenj në përshtetimin e kushteve që i ka pasur dhe është duke u punuar në këtë drejtim", ka thënë Pacolli. Po ashtu, ai e ka njoftuar ministrin holandez edhe sa i përket fushatës së Serbisë për ta dëmtuar Kosovën në arenën ndërkombëtare. Ministri i Punëve të Jashtme i Finlandës, Pekka Haavisto, të hënën është pritur në takim edhe nga kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë marrëdhëniet e Kosovës me Finlandën kanë qenë gjithmonë miqësore. Haradinaj ka treguar se ka marrë konfirmimin nga ministri finlandez se raportet ndërmjet dy vendeve do të thellohen edhe më tej në të mirën e përbashkët. "Pata kënaqësinë që të prisja në takim ministrin e Punëve të Jashtme të shtetit finlandez, Pekka Haavisto, të cilin e falënderova për mbështetjen e fuqishme për ndërtimin e shtetit të Kosovës dhe për avancimin e proceseve integruese në NATO dhe në BE. Nga ministri Pekka Haavisto mora konfirmimin se raportet tona të shkëlqyera deri më tani do të thellohen edhe më tej në të mirën e përbashkët", ka deklaruar Haradinaj.



AAK-ja i bën thirrje presidentit që ta emërojë anëtarin e saj në KQZ



PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Zyrtarët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i kanë bërë thirrje presidentit, Hashim Thaçi, që ta emërojë anëtarin e saj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në një konferencë për medie, anëtari i Kryesisë i AAK-së, Muharrem Nitaj, ka thënë se emërimi i anëtarit të tyre duhet të bëhet sa më shpejt. "Jemi

vetëm pak ditë përpara zgjedhjeve dhe AAK-ja ende nuk është e përfaqësuar në KQZ. Presidenti që do të duhej ta emëronte anëtarin nuk e ka bërë një gjë të tillë dhe kjo duhet të korrigjohet sa më shpejt. I bëjmë thirrje që ta kryejë këtë punë sa më shpejt që të mos mbetet vendi vakant në KQZ", ka theksuar Nitaj. Edhe nënkryetari i AAK-së, Ahmet Isufi, ka treguar se kjo

parti me kohë e ka propozuar Ibrahim Selmanajn për anëtar të KQZ-së. "Ne kemi bërë kërkesën që anëtari i AAK-së në KQZ të jetë Ibrahim Selmanaj, pasi që është kërkuar nga zyra e presidentit që ta dërgojmë nga një përfaqësues. Kërkojmë nga presidenti që sa më shpejt ta emëroj Ibrahim Selmanajn anëtar të AAK-së në KQZ", ka deklaruar Isufi.

Rukiqi: Qasja në financa, barrierë e të bërit biznes në Kosovë



Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka deklaruar se rritja dhe zhvillimi i bizneseve në Kosovë po ballafaqohet me disa barrierë të brendshme dhe të jashtme. Sipas tij, barrierë e jashtme e të bërit biznes është qasja në financa, ndërsa barrierë e brendshme e bizneseve është aspekti i planifikimit biznesor, orientimi strategjik dhe raportimi financiar

ajo çka kemi tash në sektorin financiar në Kosovë, gjithmonë është e mirëseardhur në kuptim që rrit qasjen në financa për kompanitë tona. Në anën tjetër, kur i analizon barrierat e brendshme të kompanive, na del se në aspektin e planifikimit biznesor, orientimit strategjik dhe në anën tjetër vetë të raportimit financiar të kompanive kemi ngecje të konsiderueshme që kompanitë tona i lënë goxha në nivel problematik të gjetjes alternativave financiare", u shpreh Rukiqi.

Kurse përfaqësuesi i Bankës Botërore në Kosovë, Marco Montavanelli, ka thënë se Banka Botërore ka mbështetur ndërmarrjet e mesme dhe të vogla në Ballkanin Perëndimor, derisa shprehu zotimin se një përkrahje e tillë do të vazhdojë tutje. Sipas tij, motor i ekonomive të vogla si kjo e Kosovës është sektori privat, prandaj ai ka thënë se përmes kësaj punëtorie po ofrohet mundësi për t'i rritur njohurit për burimet alternative për financim të sektorit privat.

Montavanelli ka theksuar se projektet e konkurrueshmërisë për NVNM ofrojnë qasje për financim dhe mundësi për rregullimin e legjislacionit dhe rritjen e inspek-

timeve. "Ne e dimë që financimi me anë të ekuitetit ose kapitalit neto për momentin ofron opsione të kufizuara në Ballkanin Perëndimor, po ashtu kemi arsye të besojmë se është në rritje e sipër dhe që në të ardhmen mund të shndërrohet në burim shumë më të rëndësishëm të financimit për zhvillimin e sektorit privat në krahasim me sot. Sot Banka Botërore vazhdon të mbetet e zotuar për t'i forcuar kapacitetet e sektorit privat në rajon dhe Kosovë, në veçanti ne jemi të vetëdijshëm që ekonomitë e vogla kanë nevojë për sektor privat të gjallërishtëm, i cili është në gjendje të prodhojë dhe eksportojë. Ju duhet t'i zgjeroni tregjet tuaja. Një prej opsioneve është qasja në financa. Ka edhe dimensionet tjera dhe ne si Bankë Botërore përpiqemi aq sa mundemi që t'i përqendrojmë kapacitetet dhe resurset tona për të ndihmuar", u shpreh ai.

Ndërkaq përfaqësuesi i Zyrës së Komisionit Evropian në Kosovë, Vaddim Delleu, ka thënë se kjo punëtori synon përmirësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Ai, po ashtu, ka deklaruar se projekti për

"Gatishmërinë e Ballkanit Perëndimor për investime të ekuitetit privat" është financuar nga Bashkimi Evropian me 3.5 milionë euro.

Delleu duke folur për projektin EDIF të Bashkimit Evropian tha se përmes këtij projekti janë financuar 4 000 kompani në Ballkanin Perëndimor duke gjeneruar 10 000 vende të reja të punës. "Ky projekt i ofron Kosovës asistencë për ta përfunduar legjislacionin e Kosovës me direktivat e Bashkimit Evropian dhe praktikën më të mira ndërkombëtare sa i përket transparencës financiare, informacionit financiar, prodhimit financiar të cilat janë elemente kyçe për qasje në kapitalin me risk dhe për kapitalet e llojeve të tjera. EDIF është një nismë që është lansuar në vitin 2012 me qëllim që të përmirësohet financimi i NMVM-ve në rajon. Është e vetmja platformë e investimeve që merr parasysh ekspertizën e ekspertëve të 27 vende të ndryshme të BE-së. BE-ja ka investuar diku 150 milionë në këtë platformë gjerë tani që ka mobiluar 700 milionë për financim të kompanive të ndryshme për NMVM në përgjithësi", ka thënë Delleu.

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) në bashkëpunim me Bankën Botërore (BB) kanë organizuar punëtori për "Gatishmërinë e Ballkanit Perëndimor për investime të ekuitetit privat", punëtori kjo që synon përmirësimin e qasjes në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka deklaruar se rritja dhe zhvillimi i bizneseve në

Kosovë po ballafaqohet me disa barrierë të brendshme dhe të jashtme. Sipas tij, barrierë e jashtme e të bërit biznes është qasja në financa, ndërsa barrierë e brendshme e bizneseve është aspekti i planifikimit biznesor, orientimi strategjik dhe raportimi financiar. "Nëse e shohim mjedisin e jashtëm të kompanive në vitin 2018 si barrierë që na është shfaqur për rritjen dhe zhvillimin e kompanive, sidomos të ndërmarrjeve të vogla, është qasja në financa dhe çdo mundësi investuese dhe çdo mundësi financimi alternativ nga

pjesëmarrësit u njoftuan gjerësisht për trajtimin tatimor të kontratave afatgjata ndërtimore, ndryshimet në Ligjin për tatim në të ardhura të korporatave, si dhe u njoftuan për projektin e fundit të ATK-së lidhur me përmirësimin e përmbushjes tatimore në sektorin e ndërtimtarisë. "Gjatë këtyre seminareve pjesëmarrësit parashtruan pyetje të ndryshme lidhur me temat e prezantuar si dhe pyetje të tjera lidhur me

legjislacionin tatimor. Për të gjitha pyetjet e parashtruara nga pjesëmarrësit janë ofruar përgjigje adekuate nga prezantuesit e temave në seminar", është thënë në njoftimin e ATK-së.

Numri i pjesëmarrësve në këto seminare ishte mjaft i lartë, si organizata biznesi, OJQ apo përfaqësues të tyre, përfaqësues të njësive të përhershme, kontabilistë dhe qytetarë të interesuar.



ATK-ja përmbylli ciklin e radhës të seminareve me tatimpagues

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me qëllim të informimit të tatimpaguesve për trajtimin tatimor të kontratave afatgjata ndërtimore, si dhe ndryshimet në ligjin për tatim në të ardhura të korporatave, ka realizuar seminare për tatimpagues në të gjitha regjionet e saj, si në: Ferizaj, Mitrovicë, Prizren, Gjiçan, Prishtinë, Pejë dhe Gjakovë. Sipas një njoftimi të ATK-së,

Nis ndërtimi i trotuareve në lagjen "Dardania" të Gjilanit

GJILAN, 30 SHTATOR (ER) - Komuna e Gjilanit ka filluar të hënën ndërtimin e trotuareve në lagjen "Dardania", kosto e të cilave është afro gjysmë milioni euro. Në fillimin e punimeve ka marrë pjesë

nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli dhe drejtori i Shërbimeve Publike, Naser Korça.

Nënkryetari Ismajli ka thënë se ndihet jashtëzakonisht mirë që ky projekt ka filluar

të zbatohet, e që do të ndikojë në qarkullimin sa më të mirë të qytetarëve atje. Ismajli ka njoftuar se përpos këtij projekti të rëndësishëm, Komuna e Gjilanit po vazhdon investimet e

mëdha në kuadër të katërshes së madhe infrastrukturore, në qytete dhe fshatra, përkatësisht në ndërtim të rrugëve, trotuareve, ndërtim të sistemit të ujësjellësit, kanalizimit e ndriçimit.



Miratohet buxheti i Komunës së Ferizajt në vlerë prej 36 milionë eurosh

FERIZAJ, 30 SHTATOR (ER) - Kuvendi Komunal i Ferizajt ka miratuar projektbuxhetin e kësaj komune për vitin 2020-2022. Duke prezantuar objektivat që përfshin ky projektbuxhet, kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se qeverisja e tij është shembull i mirëplanifikimit financiar dhe se me përgjegjshmëri do të vijoje këtë qasje drejt përmbushjes së kërkesave e nevojave qytetare. "Në këtë buxhet janë të përfshira një mori projektesh të reja, por edhe ato të mbetura. Buxheti i vitit 2020 është 16.45 për qind më i lartë sesa ai i vitit 2019 apo shprehur në vlerë buxhetore nga 30.934.846 euro është rritur në 36.023.634 euro ose 5.088.788 euro më shumë

për ferizajasit, për shërbimet komunale, infrastrukturën dhe nevojat e qytetit", ka thënë Aliu.

Ai ka theksuar se viti 2020 do ta gjejë qytetin e fshatrat e Ferizajt me zvogëlimin e përqindjes së infrastrukturës së përgjithshme të pakompletuar. "2020-a ka buxhetin e orientuar saktësisht në rritjen e kualitetit të shërbimeve publike. Ndërtimi i qendrës së re të mjekësisë familjare, shtëpisë së pensionistëve, ndërtimi i kompleksit të varrezave të reja të qytetit dhe mirëmbajtja e tij, ndërtimi i kolektorit verior të kanalizimit fekal, ndërtimi i qendrës së sporteve luftarake, rikonstruktimi i tregut të gjelbër në një model në gjithë vendin, modeli



i ri i sinjalistikës rrugore apo rregullimi teknik i komunikacionit me shenja ndriçuese, ndërtimi i strehimores për qentë endacakë, rregullimi i

tregut të kafshëve, tregjet bujqësore, vendosja e hidrantëve", ka thënë Aliu.

Më tutje, ai ka bërë me dije se në vitin e ardhshëm do të nisin

procedurat për ndërtimin e objektit të ri të komunës, si dhe nisja e procedurave për ndërtimin e objektit të stacionit të autobusëve etj.

Shpërndahen 45 centrifuga për bletarët e Skenderajt



SKENDERAJ, 30 SHTATOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka bërë shpërndarjen e 45 centrifugave për bletarët e kësaj

komune. Me këtë rast, kryetari i Skenderajt ka thënë se bujqësia ka qenë dhe mbetet prioritet i komunës që drejto-

het nga ai. "Çdo ditë në përkrahje të bujqësisë. Sot kemi shpërndarë 45 centrifuga për bletarët përfitues të

komunës tonë, me qëllim që t'i ndihmojmë në zhvillimin dhe rritjen e punës që ata po e bëjnë në sektorin e bletarisë.

Bujqësia ka qenë dhe do të jetë prioriteti ynë!", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook".

Komuna e Prizrenit ka nisur mbulimin e shpenzimeve të varrimit

PRIZREN, 30 SHTATOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar të gjithë prizrenasit se tashmë ka filluar t'i mbulojë të gjitha shpenzimet dhe

shërbimet e varrimit. "Njoftohen të gjithë qytetarët e Prizrenit se shpenzimet dhe shërbimet e varrimit tanimë po mbulohen nga Komuna e

Prizrenit. E gjitha që duhet të bëhet nga familjarët e të ndjerit në rast të vdekjes është që të lajmërohen në numrin e telefonit +383 49 305 050, për

ta treguar adresën dhe kohën se kur duhet të bëhet varrimi i të ndjerit", është thënë në njoftimin e Komunës së Prizrenit.



A duhet të arrestohet lokomotivisti

Qasje dhe përgjegjësi për t'u përmirësuar



Shkruan: Dr. Ilir RRECAJ

Para disa ditësh në Kosovë, pas një fatkeqësie, u arrestua një lokomotivist. Vetëm reagimi i kolegëve me bojkot të punës ndikoi që ai të lirohet nga burgju. Pësimet e njerëzve nuk janë temë e këtij vështrimi. Ato janë të pazëvendësueshme e llogarishme. Dhjetëra mijëra euro dëme të shkaktuara për shkak të ndalimit të punës e vonësve të udhëtarëve e mallrave, pa llogaritur vuajtjet shpirtërore të lokomotivistit. A është kjo çështje e rregulluar në aspektin ligjor dhe nëse po, a duhet harmonizuar sa më shpejt me ato të BE-së? Qytetarët duhet të informohen se hekurudha është zone e mbrojtur. Qëndrimi në hekurudhë për personat dhe mjetet private nuk është i lejuar në asnjë rrethanë. Edhe qëndrimi i personave përgjegjës duhet të bëhet vetëm me leje të veçantë. Për sinjaliz-

imin e vendkalimeve, përgjegjëse janë organet shtetërore përkatëse. Pak kohë më parë, pas një fatkeqësie në hekurudhë, u burgos një lokomotivist! U deshtë reagimi i kolegëve dhe ndalja e punës, që ai pas disa ditësh të lirohet. Edhe pse hekurudha e Kosovës ka një intensitet të ulët të veprimtarisë, me decenie shkaktohen fatkeqësi, të cilat jo rrallë kanë për pasojë përveç dëmeve materiale dhe humbje jetësh. Kjo është për keqardhje. Për keqardhje është sepse me decenie këto fatkeqësi ndodhin në mënyrë të përsëritur në disa udhëkryqe, tanimë të identifikuar "si tragjike". Pse organet përkatëse, pas gjithë këtyre viteve, nuk arrijnë të vendosin sinjalizim të duhur, është pyetje për diskutim me shpresë në regjistraturën e ardhshme qeverisëse. Nuk është e rrallë dukuria, kur personat privat kanë qëndruar në hekurudhë edhe jashtë këtyre udhëkryqeve dhe gjithashtu për pasojë ka pasur fatkeqësi e dëme. Humbjet e jetëve të njerëzve nuk diskutohen, janë gjithmonë të rënda. Dëmet materiale pastaj gjithashtu.

Por cili është roli apo "faji" i loko-

motivistit këtu?

Sipas qasjes së shteteve të Bashkimit Evropian është zero faj (me kushtin që ai të jetë i certifikuar si i aftë për punë). Në hekurudhë dhe zonën afër saj, qëndrimi është rreptësisht i ndaluar. Edhe qëndrimi i punëtorëve dhe përgjegjësve tjerë të hekurudhës, bëhet jo vetëm me leje të veçantë, që sqaron arsyen, aktivitetet që do kryhen, vendqëndrimin, kohën dhe lajmërimin e personave përgjegjës për përfundimin e qëndrimit. Vetëm atëherë hiqen masat e sigurisë. Atëherë informohen lokomotivistët, se kanë segmentin e hekurudhës të lirë për qarkullim. Këta persona (profesionistë për mirëmbajtje të hekurudhës, të rrymës, të sinjalizimit, ndërtimit, etj.), që me detyrë do të gjinden në hekurudhë, nuk mund të puij, nëse nuk kanë Certifikatë të aftësisë për punë në hekurudhë, vetëm ose në grup, lëshuar nga Specialisti i Mjekësisë së Punës. Për lëshimin e Certifikatës duhen bërë testet e dëgjimit, të të parit, duke përfshirë dallimin e ngjyrave dhe plotësuar kriteret e parapara të arritshmërisë. Gjithashtu në aspektet tjera shëndetësore si neurologjike,

kardiovaskulare, psikologjike, muskuloskeletale dhe sisteme tjera, nuk duhet të ketë mungesa, që kufizojnë aftësinë e përqendrimit, vëmendjes, lëvizjes, etj. Pra në hekurudhë mund të gjinden vetëm personat e aftë shëndetësor, të autorizuar, me informim përkatës të njësive mbikëqyrëse të sigurisë. Nëse dikush në mënyrë të paautorizuar shkel zonën e hekurudhës, duke llogaritur të dhënat teknike të trenit, mund të pësoj fatkeqësi dhe lokomotivisti në të shumtën e rasteve nuk mund të reagoj, e kështu as parandaloj fatkeqësinë. Kjo ndodhë sepse vetëm Lokomotiva ka një peshë deri në 180 tonë. Pastaj vagonët dhe ngarkesat eventuale. Nëse ky tren merr një shpejtësi prej themi 80 km në orë, me gjithë atë masë dhe me një sipërfaqe të fërkimit të ngushtë të rrotave, rruga e ndaljes së trenit pas frenimit është shumë më e gjatë se shembull i veturës ose mjeteve tjera të transportit rrugor. Bazuar në këto shkaqe teknike (dhe jo vetëm) lokomotivisti është i liruar nga çfarëdo përgjegjësie për fatkeqësinë. Si u tha më lartë gjithmonë me kushtin, që ai të ketë qenë në aspektin shëndetësor i aftë për

punë dhe pa ndikim të ndonjë substance abuzive!

Me këtë kusht, ai pas informatës për fatkeqësi, merret në kontakt nga udhëheqësi në detyrë. Lokomotivisti vendos vetë se a do të merr kujdes nga mjeku përgjegjës. Ai merret nga personeli, vendoset sipas nevojës në hotel ose i sigurohet kthimi në shtëpi. Fatkeqësia evidentohet në regjistrat përkatës si fatkeqësi në vendin e punës. Në rast të pasojave traumatike (sepse ai tenialisht përjeton rëndë fatkeqësinë të cilën nuk mund ta parandalon), sigurohet trajtimi profesional mjekësor, psikoterapeutik. Të gjitha shpenzimet e trajtimit i bartë punëdhënësi, gjegjësisht Sigurimi Ligjor i Fatkeqësive. Edhe për pasojat e mundshme afatgjata shëndetësore.

Është e ditur se shumë nga këto kushte në Hekurudhat tona momentalisht nuk plotësohen. Hekurudha as nuk konsiderohet si ndonjë zonë e veçantë (secili e shkele pa "respekt" të rrezikshmërisë), sigurime shëndetësore jo e jo. Mendoj se së paku nuk do ishte mirë që të traumatizohen me tutje këto kuadro, për të cilat duhet kohë e investime e sakrificë që të aftësohen.

Ta shpluhurojmë kujtesën



Shkruan: Iljasa SALIHU

Të jetuarit nën një kulm vetëm me gruan dhe fëmijët është më lehtë dhe më qetë. Sot shumica e të rinjve këtë formë të të jetuarit e kanë përqafuar. Madje tepër ngrohtë pavarësisht prej ndikimeve të ftohta anësore. Pak

punë, puna e prindërve! Pikërisht kur kanë nevojë për një fjalë ledhatuese dhe për një krah të shtrirë me thjeshtësi, prindërit po i braktisim e po i lëmë të shkretë. Habitshëm harrojmë se prindërit tanë po të mos na lindnin neve, do ta kishin jetën më të lehtë dhe më të qetë, mbase do të kishin edhe karrierë më të bujshme. Harrojmë se qysh me ngjizjen tonë ne u bëmë parehati për prindërit tanë. Ata përkundër kushteve të vështira ekonomike, na duronin e kënaqeshin me neve. Punonin ditë e natë, që jeta jonë të jetë më e mirë dhe më e begatshme. Flijonin gjumin,

udhëtimet dhe bukën e gojës për neve. Gërryen shpirtin kur sëmureshim. Me gjithë punën e vështirë dhe të papaguar sa duhet, ata kursenin para, jo për të shkuar në det, as për t'ia dhënë një ecje botës, por për të na mbathur, ushqyer dhe shkolluar neve. Tërë kursimet që i mblidhnin duke punuar punë nga më të ndryshme, me një bujari të lartë i drejtonin në edukimin dhe arsimimin tonë. Mjetet dhe synimet i kishin shkrirë në mozaikun e mjeteve dhe synimeve tona. Ata ndiheshin mirë vetëm kur ne ishim mirë. Edhe veten e kishin harruar për neve!

Ndonëse ata e kishin harruar edhe veten për neve, vallë si u bë që kaq shpejt i harruam të bëmat e tyre? Meqë ata edhe veten e kishin harruar për neve, si ka mundësi që ne tani t'i harrojmë vetëm ata që kurrë nuk na harruan, por jo edhe veten, jo edhe gruan, jo edhe fëmijët tanë? Po jeta më e qetë dhe rruga për karrierë më e pastër pa praninë e prindërve nën një çati! Po sikur prindërit tanë të kishin menduar dhe vepruar kështu kundrejt nesh? Ata do të shkonin çdo vjet në pushim dimëror, vjeshtor, pranveror dhe veror. Do të shëtitshin ku t'ia kishte ëndja. Do të

flinin kur të donin dhe do të zgjoheshin kur të dëshironin. Do t'i shpenzonin kursimet e tyre për gjëra luksoze. Nuk do ta kishin asnjë pengesë në karrierë. Do t'i ndërronin punët dhe vendbanimet me lehtësi. Nuk do të përjetonin fare andralla. Do të merreshin lehtësisht me sport. Spitalet shumë rrallë do t'i vizitonin. Mirëpo, ne nuk do të ishim. Nuk do të kishim mundësi të kujtojmë vetëm për veten, gruan dhe fëmijët tanë. Nuk do të kujtonim dhe nuk do të kujtoheshim, ngaqë nuk do të ekzistonim për arsye se do t'ua prishnim rehatinë prindërve tanë.

Kryetari Bahtiri viziton shkollat e mesme në Mitrovicë

MITROVICË, 30 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, i shoqëruar nga drejtori i Arsimit, Egzon Jashari, kanë vizituar disa prej shkollave të kësaj komune. Ata fillimisht kanë vizituar Gjimnazin "Frang Bardhi", Shkollën Ekonomike "Hasan Prishtina" dhe atë të mjekësisë "Xheladin Deda" për t'u njoftuar rreth procesit të pranimi të nxënësve dhe përgatitjeve të bëra për fillimin e vitit të ri shkollor.

Në Gjimnazin "Frang Bardhi" kryetari Bahtiri është pritur nga

drejtoresha e kësaj shkolle, Zybejde Gogoli-Latifi, dhe stafi mësimor. Me këtë rast, kryetari Bahtiri ka përgëzuar drejtoreshën dhe stafin arsimor për punën intensive dhe të palodhshme për mbarrëvajtjen e procesit të regjistrimit të nxënësve sipas kriterëve të parapara nga MASH-T-i.

Bahtiri ka thënë se për të pasur një shtet të zhvilluar duhet t'i kushtohet rëndësi e madhe arsimit në mënyrë që ai të jetë sa më cilësor. Ai, po ashtu, ka thënë se si kryetar komune arsimin e



trajton me prioritet dhe në mënyrë të veçantë dhe se është duke punuar intensivisht që nxënësit në vazhdimësi të kenë kushte sa më të mira për zhvillimin e procesit mësimor. Drejtoresha Zybejde Gogoli-Latifi ka falënderuar kryetarin Bahtiri për vizitën dhe mbështetjen e tij të vazhdueshme për të siguruar një arsim sa më cilësor për nxënësit tanë. Edhe drejtori i Arsimit, Egzon Jashari, ka uruar drejtoreshën dhe stafin mësimor me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor.

I jepet lamtumira ish-presidentit të Francës, Jacques Chirac

PARIS, 30 SHTATOR - Ish-udhëheqës dhe të tanishëm botërorë u mbledhën të hënën në Paris për të ndjekur funeralin e ish-presidentit të Francës, Jacques Chirac. Ceremoninë pranë vendit të varrit të Napoleonit e udhëhoqi presidenti francez, Emmanuel Macron.

Himnin kombëtar "La Marseillaise" e performoi një grup ushtarak, ndërsa Chirac u

varros në varrezat Montparnasse, ku gjendet edhe vajza e tij, Laurence, e cila ka vdekur më 2016.

Në mesin e pjesëmarrësve të huaj në ceremoni ishin: presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Bill Clinton, ish-kancelari gjerman, Gerhard Schroeder, dhe mbreti Abdullah II i Jordanisë.

Chirac vdiq më 26 shtator në moshën 86-vjeçare.

Chirac ka shërbyer si president nga viti 1995 deri më 2007.

Nën udhëheqjen e tij, Franca ka hyrë në Eurozonë dhe ka shfuqizuar shërbimin e detyrueshëm ushtarak.

Në skenën ndërkombëtare, Chirac do të mbahet mend për kundërshtimin e ndërhyrjes në Irak më 2003.



Trumpi sugjeron arrestimin e kongresistit demokrat për 'tradhti'

Presidenti Trump ka thënë se "ligjvënësi Adam Schiff në mënyrë të paligjshme sajoi një deklaratë të rreme dhe të tmerrshme, me pretendimin se e kisha bërë unë, e paraqiti si pjesën më të rëndësishme të telefonatës sime me presidentin ukrainas dhe e lexoi para Kongresit dhe popullit amerikan."

UASHINGTON, 30 SHTATOR - Presidenti amerikan Donald Trump përshkallëzoi të hënën sulmet ndaj kreut demokrat të Komisionit të Dhomës së Përfaqësuesve për Zbulimin, Adam Schiff, duke sugjeruar se ai duhet të arrestohet për "tradhti".

Schiff drejton hetimin për procedurën për shkarkim ndaj presidentit. "Ligjvënësi Adam Schiff në mënyrë të paligjshme sajoi një deklaratë të rreme dhe të tmerrshme, me pretendimin se e kisha bërë unë, e paraqiti si pjesën më të rëndësishme të telefonatës sime me presidentin ukrainas dhe e lexoi para Kongresit dhe popullit amerikan. Nuk kishte asnjë lidhje me çka thashë unë në telefonatë. Arrestim për tradhti?" shkruante ai në "Twitter".

Presidenti Trump ka bërë disa postime në "Twitter" të hënën, duke përsëritur mbrojtjen e një telefonate në korrik me presidentin ukrainas Volodymyr

Zelenskiy, e cila është në qendër të ankesës së një informatori, ka njoftuar vao. "E përsëris, presidenti i Ukrainës tha se nuk ka pasur asnjë presion ndaj tij nga unë dhe çështja është e mbyllur", tha Trumpi në Twitter.

Ndërkohë, avokatët që përfaqësojnë informatorin po theksojnë nevojën për mbrojtjen e identitetit të tij, ndërsa presidenti thotë se duhet ta "takojë akuzuesin" e tij. "Si çdo amerikan, unë kam të drejtën ta takoj akuzuesin tim, veçanërisht kur ky akuzues, i ashtuquajtur 'informator', interpretoi një bisedë të përkryer me një udhëheqës të huaj në një mënyrë krejtësisht të pasaktë dhe mashtruese", shkruante Trump në "Twitter". "Përveç kësaj, dua ta takoj jo vetëm akuzuesin tim, që paraqiti informacion të dorës së dytë dhe të tretë, por edhe personin që në mënyrë të paligjshme i dha atij informacionin, që ishte përgjithësisht i pasaktë. A po



përgjonte ky person presidentin amerikan? Pasoja të rënda!", vazhdonte ai.

Ekipi ligjor i informatorit, i kryesuar nga Andrew Bakaj, nxori një deklaratë të dielën, ku thuhej se avokatët vazhdojnë të punojnë me demokratët dhe republikanët në Kongres për t'i finalizuar detajet logjistike të takimit të informatorit me ligjvënësit, por shtoi se nuk është caktuar ndonjë datë.

Një tjetër avokat mohoi një njoftim, sipas të cilit, informatori ishte nën mbrojtje federale për shkak të shqetësimeve të sig-

urisë. Grupi ligjor publikoi një letër që i kishte dërguar Zyrës së drejtorit të Zbulimit Kombëtar ku thuhej se shqetësimet e tyre për sigurinë personale të informatorit janë shtuar javën e fundit dhe se "parashikojnë që situata të keqësohet". Ata përmendën si tregues një deklaratë të presidentit. "Dua të di se cili është personi që i dha informatorit të dhënat, sepse është si të jetë spiun. E mbani mend se si vepronim dikur kur ishim të zgjuar, apo jo? Me spiunët dhe tradhtarët... Silleshim pak ndryshe nga ç'bëjmë tani", tha

Trumpi të enjten.

Avokatët thanë, gjithashtu, se kishte njerëz që po ofronin shuma të konsiderueshme parash në këmbim të informacionit për identitetin e informatorit.

Në një letër tjetër për udhëheqësit demokratë dhe republikanë të komisioneve të zbulimit të Senatit dhe Dhomës së Përfaqësuesve, avokatët e informatorit u bënë thirrje ligjvënësve "ta ngrenë zërin në mbrojtje të informatorit dhe të rikonfirmojnë se ky është një sistem mbrojtjeje ku hakmarrja nuk lejohet, as drejtpërdrejt dhe as e nënkuptuar".

Informatori ka thënë se presidenti Trump, në një telefonatë të 25 korrikut, kërkoi ndihmë nga presidenti i ri i Ukrainës për të nxjerrë informacione inkriminuese për ish-nënpresidentin Joe Biden dhe djalin e tij Hunter që do t'i dëmtonin perspektivat e Bidenit për ta fituar emërimin presidencial të partisë demokrate dhe për ta sfiduar Donald Trumpin në vitin 2020.

Si nënpresident, Bideni dhe drejtues të tjerë perëndimorë ushtruan presion ndaj Ukrainës për ta hequr prokurorin e lartë të vendit, Viktor Shokin, sepse ai shihej si jo i ashpër sa duhet për korrupsionin. Trumpi ka pohuar se Bideni po kërkonte ta mbronte djalin e tij, por ky pretendim është hedhur poshtë.

Partia Popullore fituese e zgjedhjeve në Austri

VIENË, 30 SHTATOR - Qeveria e kancelarit Sebastian Kurz u rrëzua në muajin maj. Ai bashkëqeverisi me djathtistët e Partisë së Lirisë deri pas publikimit të një videoje që tregonte afërsinë e udhëheqësit të partnerit të koalicionit të tij me oligarkët rusë.

Duket se skandali nuk ndikoi te votuesit e Kurzit, partia e të cilit mori 6 për qind më shumë krahasuar me vitin 2017. "Nuk më ndodh shpesh, por sot jam pa

fjalë. Nuk di çfarë të them. Prisnim rezultat të mirë në këtë ditë. Prisnim që të kishim rezultat të mirë, por jo këtë rezultat. Dua t'i falënderoj votuesit për besimin. Dua ta falënderoj popullin në Austri që na qëndroi pas", tha Sebastian Kurz, ish-kancelar i Austrisë.

Majtistët Social Demokratë morën 21,7 ose 5 për qind më pak sesa në vitin 2017.

Ambientalistët e Partisë së Gjelbër kanë rritje. Në zgjedhjet e kaluara

nuk morën asnjë vend, por kësaj radhe morën 14 për qind të votave.

Partia e Lirisë, e cila shkaktoi skandalin që çoi në rrëzim të qeverisë, mori 16 për qind të votave, ose 10 për qind më pak krahasuar me rezultatet e dy vjetëve më parë.

Besohet se Sebastian Kurtz do të ketë partner të ri në qeverinë e re. 33 vjeçi ka thënë se nuk e përjashton asnjë subjekt dhe se do të bisedojë me të gjitha partitë në parlament.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E rrallë

Parada "Techno", 300 mijë veta marrin pjesë në Paris

Disa mijëra të rinj janë mbledhur në Paris për edicionin e 21 të paradës tekno, ku muzika 'house' dhe 'techno' do të kumbojë përgjatë gjithë ditës, drejtuar nga DJ të armatosur me sisteme të sofistikuara zanore. Edicioni i këtij viti i është dedikuar Stivit, studentit që humbi jetën në Nantë pas një ndërhyrjeje të polemizuar të



policiisë gjatë festivalit të muzikës që mbahet çdo vit në Francë, më 21 qershor.

FOTO E DITES

Dielli perëndon pas portës Tiananmen në Pekin. /AFP/

E jashtëzakonshme

Peshkaqeni dy metra i gjatë kapet në Himarë

Një peshkaqen dy metra i gjatë ka rënë në rrjetat e peshkatarëve të Himarës. Peshkaqeni i kapur është rreth dy metra i gjatë dhe peshon rreth 100 kilogramë. Kohët e fundit janë shtuar rastet kur këto specie bien në rrjetat e peshkatarëve shqiptarë.

**BARSOLETA E DITËS**

Vdes një person dhe kullerat shkojnë për ngushëllime. Kulleri: - Hej, njerëz, a u mërztet për tipin bre?! Shumë i smut o kon, a! Shumë mu ka dhimt, aaa! Burrat e tjerë në dhomë ia kthejnë: - Jo bre nuk u kanë i sëmurë, po kerri e ka shkelë!

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Çdo ditë në ora 16:00 **Toy Story 4 / 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi;
1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

**DASHI**

Do të vini në zbatim gjithçka që keni mësuar gjatë këtyre ditëve. Sot do të nevojiten patjetër për të zgjidhur një situatë ngërçi.

**DEMI**

Nëse nuk dëshironi të keni kundërshtime nga të gjithë sot, mundohuni të shpjegoheni sa më qartë për gjërat dhe detyrat që ju kërkojnë.

**BINJAKËT**

Ka disa rrugë ku ju mund të shkëlqeni në karrierën tuaj personale, por ka rrugë të tjera të cilat mund të bëjnë persona afër jush të triumfojnë.

**GAFORRJA**

Disa argumente të caktuara sot mund të sjellin debate të ndezura në familje. Është mirë që çdo pjesëtar ta dëgjojë tjetrin përpara se të flasë.

**LUANI**

Keni përballuar shumë sfida kohët e fundit dhe kjo ju ka dhënë mjaft vetëbesim. Mundohuni që në çdo fushë të jeni në të njëjtën frymë.

**VI RGJËR ESHA**

Një situatë emergjente dhe që e kishit neglizhuar sot do t'ju shtrëngojë të rrii shumë më gjatë në punë. Nuk jeni të sigurt nëse do ta zgjidhni.

**PESHORJA**

Dita do të nisë qetë, por disa të papritura do të ndryshojnë të gjithë rrjedhën e saj duke ju detyruar të anuloni disa plane tuajat.

**AKREPI**

Keni marrë përsipër disa aktivitete të pazakonta për ditën e sotme dhe do të shikoni që mund të jetë pak problem për t'i finalizuar.

**SHIGJETARI**

Nuk po merni vendimin më të lehtë nga ana sentimentale, por do t'i bëni shumë mirë një personi të afërt me ju.

**BRICJAPI**

Nëse sot nuk ju pëlqen të debatonit lidhur me një problem të caktuar, keni gjithë të drejtën të tërhiqeni dhe të tregoheni indiferent.

**UJORI**

Rreth jush janë krijuar pritshmëri të caktuara sepse keni treguar që mund t'i realizoni dhe të bashkëpunoni në kohë rekord për gjëra të ndryshme.

**PESHQIT**


Ditët e fundit jeni të një lajmi të rëndësishëm që do të arrijë vetëm sot. Edhe pse do të zhgënjeheni pak do të rikuperoni rrugës.

Gwyneth dhe Brad festojnë njëvjetorin e martesës



Ka qenë një vit shumë i mirë për Gwyneth Paltrow dhe Brad Falchuk. 47-vjeçarja, fituese e Oscarit, ka postuar në "Instagram" një selfie me burrin e vet 48-vjeçar, për nder të përvjetorit të tyre të parë të martesës. "Viti i parë, i përfunduar", ka

shkruar ajo nën fotografinë ku çifti shihet duke buzëqeshur, ndërsa shijuan një shëtitje përgjatë plazhit në Long Island. Gwyneth dhe Brad u martuan në shtatorin e kaluar në një ceremoni në East Hampton, Nju Jork, pas katër vjetësh në lidhje.



Kimi bëhet romantike

Kim Kardashiani nuk poston shpeshherë foto me bashkëshortin e saj Kanye West. Por sot, ylli i reality shout është bërë romantike. Vetëm pak

orë më parë bukuroshja 38-vjeçare ka publikuar një foto bardhë e zi duke puthur reperin. Duket se gjërat midis çiftit të famshëm shkojnë për mrekulli.

"Classy" i Eraldit, shqiptari i lindur në Itali që synon tregun e muzikës shqiptare



Disa artistë të rinj kanë arritur të hyjnë brenda pak muajsh në tregun muzikor shqiptar, kryesisht në fushën rapit, çka tregon se ka nisur zëvendësimi i brezit të reperëve që dominuan fillimin dhe mesin e viteve 2000. Një prej artistëve të rinj është edhe Eraldi, shqiptari i lindur në Itali, i cili së fundmi ndodhet

shpesh në vendlindjen e prindërve për ta realizuar ëndrrën e tij, të bëhet një artist i suksesshëm. "Classy" është kënga më e re që publikon Eraldi. Karrierën e ka nisur duke bashkëpunuar me njerëz ndër më të rëndësishmit në botën e muzikës, si Dj A-Boom dhe videomakeri Alban Selimaj.


Rami Malek, i vetëm rrugëve të Nju Jorkut



Rami Malek së fundmi është parë duke shëtitur në Nju Jork. 38-vjeçari, fitues i Oscarit, kishte të veshur një bluzë të bardhë dhe xhinse të zeza derisa po lëvizte i vetëm. Një natë më parë

Rami dhe e dashura e tij Lucy Boynton u panë dorë për dorë për një natë me datë të rëndësishme. Gjatë asaj dite Rami bëri një paraqitje në Global Citizen Festival 2019.

2

A black and white portrait of Ice Cube. He is looking directly at the camera with a neutral expression. He has short, dark hair styled in a flat-top or crew cut. He is wearing a dark, possibly black, jacket over a dark t-shirt. A thick, multi-strand chain necklace is visible around his neck. The background is out of focus, showing some text like "DIRTY" and "EAST" in large, bold letters.[illegible]

3 emra në murin e nderit në Tel-Aviv: Dr.Stiliano, Vasili e Adelina



Pllaka me falenderimin e pupullit hebre në Tel-Aviv

Dy nipërit dhe mbesa e Lef Nosit, pinjollët e familjes atdhetare, të lagjes Kala në Elbasan, që përjetuan kalvarin e burgjeve komuniste... Një histori e shkurtër e doktorit humanist të Elbasanit dhe fundi tragjik i të vëllait Vasili...

Në një fasadë në Tel-Aviv, që quhet "Muri i Nderit", janë shënuar tre emra: Vasil Nosi, Adelina Nosi e dr. Nosi (Stiliano Nosi). Ata janë nderuar nga shteti izraelit, për ndihmën që dhanë, duke strehuar shtetas hebrej në Elbasan, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Janë fëmijët e Grigorit dhe Eleonorës, familja atdhetare e lagjes "Kala" në Elbasan. Babai i këtyre tre shqiptarëve që na nderojnë në murin e nderit në Tela-Aviv, është Grigori, vëllai i Lef Nosit, një ndër figurat më të shquara të Shqipërisë së shekullit të shkuar.

Por këta tre shqiptarë që i japin nder kombit të tyre, janë përbuzur dhe më keq akoma, janë dënuar si armiq të popullit,

gjatë diktaturës komuniste. Kur Lef Nosi u dënuar me pushkatim nga regjimi komunist, në atë gjyq, u dënuan edhe disa familjarë e miq të tij. Ata e kishin ndihmuar të rrinte i fshehur, në përpjekje për ta shpëtuar nga regjimi komunist. Nipi i tij Stiliano ishte një ndër familjarët më aktiv që u angazhua për ta fshehur e shpëtuar Lef Nosin nga bishat komuniste.

Ja si e ka rrëfyer Adelina Nosi Kosturi, kohën kur u zbulua vendi ku fshihej Lef Nosi dhe si u dënuan njerëzit që e ndihmuan atë.

"Më 12 shkurt 1946, gjyqi ushtarak i Tiranës dënoi me vdekje Lef Nosin dhe me dënime të ndryshme, nga 6 në 4 vjet, për personat që ndihmuan që ai të fshihej. Vasil Nosi, Steliano Nosi, Marko Menahemi, Xhemal Farka, Fahrije Averiqi dhe Adem Samurri" ka rrëfyer Adelina Nosi Kosturi, motra e doktorit Stilianit.

Doktor Stialiani do të dënohej me pesë vite burg. Ndërsa i vëllai, Vasil Grigor Nosi u dënuar me 6 vjet dhe atje ndërroi jetë në burg, për shkak të torturave.

Pas kryerjes së dënimit, doktor Stiljano u kthye në detyrë sepse Elbasani kishte shumë nevojë për të. Ai i shërbeu njerëzve të qytetit të tij, me humanizëm të rrallë. Vështirë se gjen shtëpi të Elbasanit, të para vitit 1984, ku të mos ketë shkelur doktor Stiliani. Ndërkohë, doktor Stiliani përndiqej papushim nga regjimi komunist. Studiuesi Kastriot Dervishi ka publikuar së fundmi të dhëna të Dosjes së Sigurimit, që rrëfen detaje të përndjekes së doktor Stilianit.

"Më 21.10.1949 është marrë në kontroll operativ 2B dhe 31.3.1984 në përpunim aktiv 2A "si agjent i mundshëm anglez". Përpunimi nuk zgjati shumë, pasi doktor Nosi vdiq. Në shkurt 1980, Stiliano Nosi i është shprehur bashkëpunëtorit "Tomori": Khomeini, për mendimin tim, është një Haxhi Qamil i dytë, si nga pikëpamjet fetare, ashtu edhe politike dhe ushtarake, s'ka si të jetë ndryshe... Ndërsa Haxhi Qamili mburrej se do të luftonte armiqtë e brendshëm, ashtu edhe të jashtëmit, edhe Khomeini deklaroi se do të luftojë kundër SHBA-së e BS-së dhe reaksionit të brendshëm. Këto janë aventura". Punëtori operativ vendos këtë shënim: "E dhëna ka vlerë operative, pasi Stilian Nosi ul shumë poshtë veprimtarinë revolucionare të Khomeinit dhe njëkohësisht, veprimtarinë patriotike të Haxhi Qamilit". Iu dha detyra që të hapë biseda rreth luftës së popullit iranien dhe rreth Haxhi Qamilit, duke përdorur edhe



veprat e Enver Hoxhës për të. Edhe pas vdekjes ndaj tij u ndërmor një veprim i shëmtuar, krejt i padëgjuar më parë", shkruan Dervishi.

Në shkurt të vitit 1984, doktor Nosi ndërroi jetë. Ishte me ste-

toskop në dorë, duke vizituar pacientët e tij. Doktor Nosi është një ndër personalitetet më të rëndësishme të qytetit të Elbasanit. Është nderuar me titullin: Qytetar Nderi i Elbasanit. /Kujto.al/

Zbulohet historia e Mercedesit që Hitleri i dhuroi Zogut

Mercedezi i dhuruar nga Hitleri ishte i vetmi objekt që mbijetoi nga gjithë pasuria personale që ishte marrë me vete nga familja mbretërore, aq sa gjyshja e Geraldinës e shihte atë si një ogur të keq. Nuk ishte e lehtë të udhëtoje në mes të luftës në rrugët e Londrës me një makinë krenare gjermane dhe konsumuese të madhe benzine, që në Anglinë e luftës jepej vetëm me tollon. Geraldina dhe gjyshja e saj e shitën pa e njoftuar Zogun. Dikush u ofroi një çek për Mercedesin por doli që ai ishte i rremë. Policia arriti ta gjejë në garazhin e një skocezi që e kishte blerë për 800 paund. Zogu u

detyrua t'i jepte këto para në dorë pronarit të ri dhe risolli me triumf në garazhin e shtëpisë "Parmoor", mercedezin e tij. Pak kohë më pas, duke respektuar dëshirën e Geraldinës, ai e fali mercedezin tek Kryqi i Kuq.

Mercedezi përfundoi në ankand dy vite më vonë dhe u shit për 3 250 sterlina. Makina ndodhet sot në një koleksion privat dhe vlerësohet me një vlerë të konsiderueshme, e denjë për koleksionistë makinash të rralla.


**Marrë nga statusi në facebook i studiuesit Erald Kapri, i cili e shoqëron me shënimin: Pjesëz nga libri që pritet të botohet së shpejti.*





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adri: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Zhdrella: Feronikeli meriton respekt, por nuk është i pathyeshëm

Mentor Zhdrella ka folur të hënën për "Epokën e re" në lidhje me ndeshjen derbi Feronikeli - Llapi, kurse ka thënë se kampionët në fuqi të elitës nuk janë të pathyeshëm. "Skuadra e Feronikelit është shumë cilësore dhe meriton respekt nga të gjithë, por ne do të shkojmë në Drenas për rezultat pozitiv. Do të jetë vështirë për ta marrë maksimumin, por jo edhe e pamundur, sepse Feronikeli nuk është skuadër e pathyeshme", ka deklaruar Zhdrella



limit të kampionatit. Dhe duke pasur parasysh se na nevojitet edhe pak kohë që të komponohem si duhet, mund të them se në ndeshjen e ardhshme Llapi do të paraqitet edhe më mirë dhe do të marrë edhe më shumë pikë", ka thënë Zhdrella. Skuadra e Llapit në fundjavë arriti fitore ndaj Dukagjinit të Klinës me rezultat 2-1, edhe përkundër faktit se një pjesë të madhe të ndeshjes e luajti me një lojtar më pak në fushë, kurse të mërkurën e pret një derbi i vështirë ndaj Feronikelit në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Zhdrella, që në të kaluarën ka djersitur fanellën e "Niklit", ka shprehur optimizëm për këtë ndeshje. "Skuadra e Feronikelit është shumë cilësore dhe meriton respekt nga të gjithë, por ne do të shkojmë në Drenas për rezultat

min "Fadil Vokrri" në kryeqytet, derisa ndaj Dritës arriti të shpëtojë, duke e barazuar rezultatin në fund të ndeshjes 2-2.

FFK-ja denoncon në polici shitjen ilegale të fanellave të Kosovës

Federata e Futbollit e Kosovës e ka denoncuar në polici shitjen ilegale të fanellave të Përfaqësueses së Kosovës nga dyqane online në rrjetet sociale, siç është rasti i fundit me "RK" Sport Shop". FFK-ja sqaron opinionin se falsifikimi i

tillë nuk do të tolerohet në asnjë mënyrë dhe të gjithë ata që do ta bëjnë shitjen e tillë të fanellave do të paraqiten në prokurorinë e shtetit dhe në Agjencinë e të Drejtave Autoriale dhe do të dënohen sipas ligjeve në fuqi të Kosovës. Njëherësh, FFK-ja bën me dije se fanellat origjinale të përfaqësueses të interesuarit mund t'i blejnë në dyqanin zyrtar të kompanisë "Fourteen". FFK-ja është duke bërë punuar për hapjen e dyqaneve zyrtare edhe në Kosovë për shitjen e fanellave të përfaqësueses, për çka opinionin do të njoftohet me kohë.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Pas shtatë xhirove të zhvilluara në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, skuadra e Llapit renditet në pozitën e tretë me pikë të barabarta me Dritën që është e dyta dhe një pikë më pak se skuadra lidere, Feronikeli.

Kapiteni i Llapit, Mentor Zhdrella, ka thënë të hënën për "Epokën e re" se është i kënaqur me rezultatet e arritur nga skuadra e tij për faktin se në afatin kalimtar të verës ka bërë shumë ndryshime në radhët e futbollistëve. Mesfushori me përvojë të madhe është optimist se Llapi në ndeshjet e ardhshme do të jetë skuadër edhe më e fortë dhe se do të arketojë më shumë pikë. "Ekipi ka pasur shumë ndryshime para fil-

limit të kampionatit. Dhe duke pasur parasysh se na nevojitet edhe pak kohë që të komponohem si duhet, mund të them se në ndeshjen e ardhshme Llapi do të paraqitet edhe më mirë dhe do të marrë edhe më shumë pikë", ka thënë Zhdrella. Skuadra e Llapit në fundjavë arriti fitore ndaj Dukagjinit të Klinës me rezultat 2-1, edhe përkundër faktit se një pjesë të madhe të ndeshjes e luajti me një lojtar më pak në fushë, kurse të mërkurën e pret një derbi i vështirë ndaj Feronikelit në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Zhdrella, që në të kaluarën ka djersitur fanellën e "Niklit", ka shprehur optimizëm për këtë ndeshje. "Skuadra e Feronikelit është shumë cilësore dhe meriton respekt nga të gjithë, por ne do të shkojmë në Drenas për rezultat

Selmani: Na duhet përkrahja e tifozëve

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Një nga klubet më me traditë në basketbollin e Kosovës është Trepça. Mitrovicasit gjithmonë kanë luftuar për trofe, edhe pse në vitet e fundit janë përballur me shumë vështirësi.

Trajneri i skuadrës, Ilir Selmani, ka folur për vështirësitë që kanë. "Përgatitjet i kemi filluar me vonesë për shkak se, siç dihet, në vitet e fundit jemi duke u përballur me kushte të rënda financiare dhe kjo është arsyeja pse Trepça ndodhet në këtë gjendje aktualisht. Është e vështirë që të punohet profesionalisht, sepse për dy-tri javë nuk mund ta përgatitësh skuadrën për një kampionat. Aktualisht kemi tre lojtarë të huaj në ekip dhe fatmirësisht i kemi mbajtur lojtarët vendorë përveç Samirit (Zekiqit) dhe jemi një numër i vogël i loj-



tarëve në rotacion, por në mesin e tyre janë edhe 3-4 lojtarë të rinj që vijnë nga grupmosha juniore, që mua si trajner më gëzon ky fakt. Jemi duke u stërvitur dhe po mendoj se janë duke shkuar mirë stërvitjet dhe shpresoj se do të jemi të gatshëm për kampionat, edhe pse

jo në formën më të mirë të mundshme", është shprehur Selmani për faqen zyrtare të FBK-së. "Sa iu përket synimeve, me vetë faktin se në çfarë gjendje jemi aktualisht, ne do të mundohemi ta japim maksimumin e të bëjmë lojëra të mira, edhe pse do të kemi shumë vështirë, sepse të gjitha skuadrat kanë angazhuar nga 5-6 basketbollistë të huaj. Në këtë gjendje që jemi na duhet përkrahja maksimale nga qytetarët e Mitrovicës dhe nga tifozët tanë, 'Torcida', që ta tejkalojmë këtë gjendje, duke shpresuar në ditë më të mira për sportin mitrovicas, përkatësisht basketbollin, andaj i ftoj të gjithë të vijnë të na përkrahin", ka shtuar Selmani. Trepça në xhiron e parë ka pushuar, kurse të mërkurën do të përballlet me Bashkimin.

Vëllezërit Lushi do të testohen në Winterthur të Zvicrës



PEJË, 30 SHTATOR - Avdullah dhe Herolind Lushi nga Qyshku i Pejës, të cilët janë të lindur në vitin 2004, respektivisht 2006, janë ftuar në prova nga ish-reprezentuesi zviceran Bruno Sutter, i cili drejton një Akademi të futbollit në Zvicër. Vëllezërit Lushi kanë marrë ftesë dhe pritet që të pajisen me viza zvicerane e më pas të testohen në klubin F. C. Winterthur. Njoftimin në rrjetin social "Facebook" e ka bërë prindi i tyre Naim Lushi i cili është lutur që këta dy djem të mos kenë vështirësi për t'u pajisur me viza dhe për ta provuar fatin e tyre, fat që do t'i

sjellë edhe atyre të mira materiale, por edhe Kosova të ketë dy talentë në ardhje të gatshëm që me nder e krenari t'i mbrojnë ngjyrat e saj. "Avdullahi dhe Herolindi sapo morën ftesë nga ish-reprezentuesi i futbollit zviceran Bruno Sutter për të shkuar në prova në Zvicër, gjegjësisht përmes Akademisë së tij të Futbollit të testohen në Winterthur FC. Uroj që të mos kemi pengesa për marrjen e vizave dhe të shfrytëzohet kjo mundësi e artë nga talentet e mi dhe të Kosovës në futboll të cilët besoj që do të na bëjnë krenarë të gjithëve", ka shkruar Naim Lushi.

Westbrooki: Me Hardenin do të jemi dyshe e frikshme në NBA

HOUSTON, 30 SHTATOR - Skuadra e Houston Rocketsit konsiderohet një nga skuadrat favorite për titullin kampion në NBA sezonin tjetër. Ky vlerësim vjen pas transferimit të Russell Westbrookut tek

ekipi i Rocketsit, duke formuar një dyshe të frikshme me James Hardenin. Duke folur për mediet në ditën e parë të fazës përgatitore, Westbrook ka thënë: "Unë dhe Hardeni do të jemi një dyshe e frikshme. Kjo është

